

Monitorimi i Prokurimit Publik

1. Më 24 Mars 2010, me iniciativën e Lëvizjes FOL, Ministria e Drejtësisë nënshkroi memorandumin e mirëkuptimit për monitorimin e prokurimit në këtë institucion. Ky lloj memorandumi është i pari i llojit të tillë i bashkëpunimit me shoqërinë civile për luftimin e korrupsionit në sektorin e prokurimit. Gjithashtu është hera e parë që zyrat e prokurimit hapen për mbikëqyrje nga shoqëria civile.
2. Pas nënshkrimit të memorandumit me MD, me 25 mars përmes kërkesave zyrtare, Lëvizja FOL ka kërkuar qasje në monitorimin e prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës, Shëndetësisë, Administratës Publike dhe Arsimit. Kërkesës së Lëvizjes FOL iu janë përgjigjur pozitivisht Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Administratës Publike. Memorandumi me Ministrinë e Administratës Publike është nënshkruar me 23 maj 2011, ndërsa me atë të Shëndetësisë me 10 qershor 2011.
3. Memorandumet e nënshkruara nga lëvizjes FOL i ofrojnë organizatës qasje të plot në dokumentacion dhe në takimet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave.
4. Që nga fillimi i monitorimit të Prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë, FOL ka monitoruar 16 procedura të prokurimit (duke mos i përfshirë ri-tenderimet) prej të cilave janë anuluar ose ri-tenderuar 5 tenderë, ku janë kursyer rreth 3 milion euro të taksapaguesve të Republikës së Kosovës. FOL ka hartuar pesë raporte të vlerësimit të procedurave të prokurimit.
5. Që nga fillimi i monitorimit të Prokurimit në Ministrinë e Administratës publike, që realisht ka filluar nga 7 korriku, kemi monitoruar 7 tenderë prej të cilëve një tenderë është ri-shpallur edhe dy herë të tjera. Për herë të parë, me iniciativën e FOL, disa gazeta janë ftuar të monitorojnë procedurat e vlerësimit të ofertave milionëshe për ndërtimin e ndërtesës së MFSK.
6. Kurse në Ministrinë e Shëndetësisë, megjithëse ka memorandum të nënshkruar me Ministrin Agani, zyra e prokurimit nuk ka qenë bashkëpunuese duke refuzuar pjesëmarrjen e FOL në takimet e vlerësimit të ofertave. FOL ka përgatitur një Raport për keqpërdorime në këtë ministri edhe po presim që me 24 gusht të diskutojmë këtë raport me ministrin, të cilin raport pas takimit do ta bëjmë edhe publik.
7. Transparenca dhe llogaridhënia ne shpenzimin e parasë publike është qenësore për një qeverisje të mirë dhe demokratike. Monitorimi i prokurimit, i konsideruar si sektori më i korruptuar, është një hap i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ne, vlerësojmë se vetë prezenca e FOL në procedurat e monitorimit të prokurimit ka shërbyer si masa parandaluese për keqpërdorime, më tej është rritur përgjegjësia e ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave. Lëvizja FOL gjithashtu është duke përgatitur një lëndë për prokurorinë për një tenderë në Ministrinë e Infrastrukturës. Çdo muaj do të publikohet “Monitoruesi i Prokurimit”. Gjithashtu Lëvizja FOL ka qenë anëtare e grupit punues për ndryshimin e ligjit për Prokurim Publik, ku ka kontribuar me 20 rekomandime.